

INFORMACION DHE IDENTITET - Parma, 27 nëntor 2010

Gjatë javës së kulturës shqiptare në Parma 22-28 nëntor 2010, Shoqata Scanderbeg [Parma] në bashkëpunim me Shoqatën Alba Media [Modena], gazetën shqiptare online Albanianews.it, Resi Mobile Group dhe Poste Mobile, organizon një takim publik rreth çështjeve të integritit, mediave dhe shoqatave të emigrantëve, me titull "Informacioni dhe Identiteti".

E shtunë 27 nëntor 2010

ora 15.00 - 19.30

Teatro/Cinema Edison, Largo 8 Marzo n. 9, Parma

Programi:

15.00 - 16.30

Albania News: kur informacioni zhbën skemat tradicionale.

Gerarta Zheji Ballo bashkëbisedon me Darien Levani, Darina Zeqiri, Pietro Tarozzi, Manfred Bushi, Olti Buzi.

Realitet dinamik, vullnetar e migrues, Albania News është themeluar më shumë se dy vjet më parë nga një grup të rinjsh shqiptarë. Falë aksesit e demokratishmërisë më të madhe dhe kostos më të ulët, interneti do të jetë mjete i informacionit në të ardhmen. Albania News ka ndërmarrë këtë sfidë, duke u propozuar si "new media" me një redaksi dhe rrjet bashkëpunëtorësh shqiptarë e italianë aktualisht të ndërtuar mbi bazë vullnetare.

Nga ana tjetër, mediat tradicionale vazhdojnë, në disa raste në mënyrë të ndërgjegjshme, të përhapin një informacion dhe kulturë e cila e sheh tek i huaji, të sapoardhurin, "plëngprishësin" që dëmton mirëqenien, të kaluarën dhe liritë e vendasve. Në këtë kontekst, Albania News propozohet si media ndërkulturore, në të cilën vetë të huajt, në këtë rast shqiptarët, janë protagonistë dhe përhapës të informacionit që u përket si emigrantë po dhe si qytetarë të Shqipërisë.

17.00 – 19.00

Tryezë e rrumbullakët: Shoqatat si mjet për zbulimin dhe vlerësimin e identitetit.

Manfred Bushi bashkëbisedon me Ismail Ademin, Endri Xhaferraj, Antonio Caiazza dhe Vincenzo Romania.

Në njëzetvjeçarin e eksodit të parë të shqiptarë në ambasadat e vendeve perëndimore, përfshirë dhe atë italiane, në Tiranë në korrik 1990, fizionomia e migracionit shqiptar ka ndryshuar shumë. Prej atij viti, eksodet vazhduan edhe në mars e gusht të 1991-shit, në 1997-ën dhe nuk munguan largimet drej Italisë nëpërmjet deteve Jon dhe Adriatik.

Nga Fatmiri, shoferi i kamionit i cili shembi murin e ambasadës italiane në Tiranë duke nisur një eksod që vazhdon ende, treguar me mjeshtëri nga gazetari Antonio Caiazza në librin e tij "In alto mare", deri në mimetizimin social zgjedhur nga shumica e qytetarëve shqiptarë si model integrimi në shoqërinë italiane, të përshkruar nga sociologu Romania në librin e tij "Farsi passare per italiani", duket sikur komuniteti shqiptar që jeton në Itali po del gjithnjë e më shumë në të hapur.

Faktor emigrimi njëzet vjeçar, stabiliteti ekonomik, integrimin në jetën sociale, pune e institucionale, ka bërë që të rritet dëshira për komunitet dhe pjesëmarrje në sferën publike italiane. Dëshmia vjen nga vetë shoqatat dhe kohët e fundit nga krijimi i rrjeteve të shoqatave në nivel rajonal në Emilia Romagna dhe Toscana, objektivat e të cilave kanë të bëjnë jo vetëm me promovimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës, por edhe pjesëmarrjen e komunitetit shqiptar në jetën sociale, kulturore dhe politike në këto dy rajone.

Të ftuarit

Gerarta Zheji Ballo, gazetare, drejton emisionin "Shqip in Torino" në Radio Torino International, program i përditshëm radiofonik në gjuhën shqipe ideuar nga vete ajo. Bashkëpunon me gazetën italiane "La Stampa", faqen web të rinjve nga Torino Digi.To, revista Evropian në gjashtë gjuhë Cafebabel, dhe korrespondente e gazetës shqiptare "Tirana Observer".

Darien Levani, Darina Zeqiri, Pietro Tarozzi, Olti Buzi e Manfred Bushi bëjnë pjesë në redaksinë Albania News, gazetë online në italisht, themeluar në mars 2008. Lajmet janë kryesisht rreth Shqipërisë, Kosovës, marrëdhëniet mes Italisë dhe Shqipërisë, komunitetit shqiptar në Itali dhe migrimit.

Ismail Ademi, President i RAT, Rrjetit Shqiptar në Toscana. RAT, themeluar më 24 tetor të këtij viti, është i përbërë nga katër shoqata shqiptare të Rajonit të Toskanës, dhe do të hapë zyrat e saj në të gjithë rajonin në sajë të një marrëveshjeje me ACLI Toscana. Qëllimi është koordinimi dhe strukturimi i pranisë së komunitetit shqiptar në rajon, duke ofruar hapësirë dhe mënyra pjesëmarrjeje të gjerë. Aktiviteti i rrjetit është i hapur për individë, shoqata, grupe joformale, nxënës dhe të gjithë ata që punojnë për komunitetin shqiptar në këtë rajon.

Endri Xhaferaj, President i Rrjetit F.A.R.E., Forumi i Shoqatave Shqiptare në Emilia Romagna, dhe Shoqatës Juvenilja ne Forlì. Forumi, themeluar më 29 tetor të këtij viti, përbëhet nga 8 shoqata shqiptare të Rajonit Emilia Romagna, dhe është rezultat i një rruge të përbashkët që zgjati më shumë se shtatë muaj. Ndër objektivat e këtij rrjeti janë pjesëmarrja e qytetarëve të huaj në sferën publike, promovimi i gjuhës shqipe dhe kulturës, forcimin e OJQ-ve dhe të marrëdhënieve midis Italisë dhe Shqipërisë.

Antonio Caiazza, gazetar dhe shkrimtar, ka bashkëpunuar me «Il Mattino» në Napoli, «TriesteOggi», «L'Adige», ka qenë korrespondent i Italisë për TeleCapodistria e aktualisht punon si redaktor për Rai'n e Friuli-Venezia Giulia. Ka publikuar në 2008 për Instar Libri të Torinos: "In alto mare. Viaggio nell'Albania dal comunismo al futuro".

Vincenzo Romania, studiues dhe profesor i sociologjisë të komunikimit në Universitetin e Padovës. Ka koordinuar e ka marrë pjesë në disa projekte e hulumtime kombëtare, duke përfshirë edhe kërkimin në projektin "Facilitatori Culturali" të Bashkisë së Padovës (2007), hulumtimi i IOM-it në integrimin e shqiptarëve në Itali (2001). Botimet e tij përfshijnë: "Farsi passare per italiani. Strategie di mimetismo sociale"(Carocci, Romë, 2004),"Identità e performance"(Carocci, Romë, 2005),"Le cornici dell'interazione"(Liguori, Napoli, 2008).

Për informacione: info@albanianews.it